



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 957 / Prot.
125

Tiranë, më 25/09/2023

V E N D I M

Nr. 21, datë 25.09.2023

P Ë R

MIRATIMIN E TARIFAVE TË REGJISTRIMIT DHE TARIFAVE VJETORE TË SHKOLLIMIT PËR PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË "BACHELOR", PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, SI DHE PROGRAMEVE TË CIKLIT TË DYTË "MASTER PROFESIONAL" DHE "MASTER I SHKENCAVE" ME KOHË TË PLOTË, PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024 NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 3, pika 3, shkronja c; Vendimin nr. 288, datë 21.05.2018 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkolimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë", i ndryshuar; Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, neni 26, pika 3; si dhe vendimin nr. 8, datë 18.04.2023 të Senatit Akademik, Bordi i Administrimit,

V E N D O S I:

1. Të miratojë tarifat e regjistrimit për programet e studimit në Universitetin Politeknik të Tiranës për vitin akademik 2023 – 2024, sipas tabelës nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të miratojë tarifat vjetore të shkollimit për programet e studimit të ciklit të parë "Bachelor", programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, si dhe programet e studimit të ciklit të dytë "Master Profesional" dhe "Master i Shkencave" me kohë të plotë, për vitin akademik 2023 – 2024 sipas tabelave nr. 2, 3 dhe 4 bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Tarifa e shkollimit paguhet nga studentët në masën, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi.
4. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi. Studenti i cilësuar në bazë të rregullores së institucionit si përsëritës, i nënshtrohet tarifës vjetore të shkollimit të vitit akademik në të cilin vazhdon studimet.

5. Studenti i regjistruar në një program të ciklit të parë ose në një program të integruar të studimeve, i cili nuk i ka shlyer të gjitha detyrimet e parashikuara në programin përkatës të studimit brenda kohëzgjatjes normale të tij (3 vjet cikli i parë dhe 5 vjet studimet e integruara), do të paguajë vetëm për provimet që do të japë për lëndët e mbartura gjatë vitit akademik 2023 - 2024.
6. Studenti i regjistruar në një program të ciklit të dytë "Master Profesional" dhe "Master i Shkencave", i cili nuk i ka shlyer të gjitha detyrimet e parashikuara në programin përkatës të studimit brenda kohëzgjatjes normale të studimit, do të paguajë vetëm për provimet që do të japë për lëndët e mbartura gjatë vitit akademik 2023 – 2024.
7. Pagesa e tarifës së shkollimit për ciklin e parë të studimeve dhe programin e integruar të studimeve, kryhet përpara fillimit të sezonit të provimeve të dimrit.
8. Pagesa e tarifës së shkollimit për ciklin e dytë të studimeve, kryhet e ndarë në 2 (dy) këste. Kësti i parë të paguhet përpara fillimit të sezonit të provimeve të dimrit dhe kësti i dytë paguhet përpara fillimit të sezonit të provimeve të verës.
9. Në situata objektive që e bëjnë të pamundur respektimin e afateve të përcaktuara për pagesën e tarifës së shkollimit, njësitë kryesore të kenë mundësi veprimi për metodologjinë dhe afatet e pagesave.
10. Ngarkohet Administratori i Institucionit dhe fakultetet për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI

